

**AKT THEMELIMI  
DHE  
STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE  
“T&M Construction” sh.p.k**

Tiranë më datë 18.06.2024.

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Shoqëria Tregtare “T&M Construction” sh.p.k rregullon pozitën e saj juridike, marrëdhëniet e themeluesve, të organeve të saj, llojin e Shoqërisë, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar, dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

Ortak i shoqërisë do të jetë:

- Shoqëria “EBG” sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L12121026C, me seli në Tiranë, me adresë Rruga “Mustafa Matohiti” Vila Nr. 2/99, Njesia Bashkiake Nr. 2, Tirane, me ortak të vetëm z. **Erion Gina**, përfaqësuar nga Administratori **Ermal Buka**, atësia Gani, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Rr. Egnatia; Nd. 922; H. 1; Ap. 8; Durrës, lindur më 31/05/1979, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 037480124 dhe nr. personal H90531112H.

Shoqëria gëzon të drejta si person juridik, që prej datës në të cilin është kryer regjistrimi i saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**NENI 1. Emri dhe selia e Shoqërisë**

Shoqëria është Person Juridik Privat.

Shoqëria paraqitet në qarkullim me emërtimin e saj “**T&M Construction**” sh.p.k.

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën:

Rr. “Faik Konica”, Godina “Lion Residence” Kati 0, Njësia Bashkiake Nr. 2, Tiranë, Shqiperi.

Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në cilësinë e ortakut ose aksionerit në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

**NENI 2. Kohëzgjatja e Shoqërisë.**

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin ose zgjatjen e afatit të veprimtarisë të shoqërisë, sipas një vendimi të posaçëm.

**NENI 3. Objekti i veprimtarisë**

Faqja 1 nga 9



Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është:

1. Projektimi dhe ndërtimi i objekteve civile dhe industriale dhe menaxhimi i zbatimit të projekteve të kësaj natyre për vete dhe për të tretë; Shitja e objekteve/njësive të ndërtuara si investitor dhe ose subjekt ndërtues dhe/ose dhënia e tyre me qira;
2. Aktivitet në fushën e ndërtimeve civile, objekte shërbimi dhe banimi; rrugë; ura; porte; trase hekurudhore; terminale; hidrocentrale; veprave bonifikuese; parkimeve nëntokësore dhe cdo ndërtim tjetër; punime ndërtimore në nëntokë dhe në lartësi.
3. Rikonstrukcion i ndërtimeve civile dhe restaurime të objekteve historike, fetare dhe objekteve të tjera. Studim, projektim i ndërtimeve të ndërtesave publike, rrugeve, urave, tuneleve, traseve hekurudhore, veprave bonifikuese, centrale, objekte turistike, terminale, parkime nëntokësore, industriale, objekte të kulteve, realizim të studimeve urbane, restaurime, prodhim të materialeve të ndërtimit.
4. Aktivitet në fushën e pasurive të paluajtshme si blerje, shitje, marrje me qira, menaxhimi i pasurive të paluajtshme. Aktivitet në menaxhimin e qendrave të biznesit; qendrave tregtare; terminaleve; porteve; aeroportëve; dhe shërbimeve të ngjashme.
5. Aktivitet në fushën e financimit, investimit dhe menaxhimit të projekteve koncesionare; partneritet publik privat; partneritetit duke krijuar shoqëri të thjeshta; partneritet me shoqëri shqiptare dhe/ose të huaja.
6. Prodhim dhe Tregtim materiale ndërtimi, inerte, rere, mermer, etj. Import- eksport të mallrave të ndryshme, industriale, materiale ndërtimi dhe hidrosanitare, makineri të cdo lloji, si dhe shit-blerjen e tyre me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Prodhim dhe tregtim makineri e pjese kembimi për llojet e ndryshme të makinerive.
7. Ushtrimi i veprimtarisë në fushën e administrimit të ndërtesave dhe të bashkëpronësisë së ndërtesave të banimit, të truallit dhe mjediseve ndihmëse që janë në bashkëpronësi të detyrueshme, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 10112, datë 09.04.2009 "Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;
8. Shoqëria kryen cdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektit të saj duke përfshirë edhe veprime për shitblerje sendesh të luajtshme e të paluajtshme, pjesëmarrje në kuota dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera.
9. Blerja, shitja dhe administrimi i aksioneve, bono, të letrave me vlerë të borxhit publik dhe privat në përgjithësi, të aksioneve në kompani, letra me vlerë, pasurive financiare, industriale, tregtare dhe pasurive të paluajtshme.
10. Shoqëria mund të përmbushë të gjitha operacionet tregtare, në fushën e pasurive të paluajtshme, financiare dhe industriale që do të konsiderohen të nevojshme nga organi administrativ ose të dobishme për të arritur qëllimin e shoqërisë.
11. Shoqëria mund të kryejë transaksione financiare, dhe të pasurive të paluajtshme që do të konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, të marre pjesë në shoqëri të tjera me objekt të njëjte, të ngjashëm apo që lidhet me aktivitetin e vet kryesor, si dhe të japë garanci për hua si dhe garanci hipotekore në favor të ortakëve dhe në favor të të tjerëve.

#### **NENI 4. Regjimi Juridik i Shoqërisë.**

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit- Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi. Me vendim të



Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vulën e saj.

## **II. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQËRISË.**

### **NENI 5. Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën **100,000 (nje qind mijë) lekë**. Kapitali ndahet në 1 pjesë (kuotë) dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

#### **Oraku Themelues:**

**Shoqëria “EBG” sh.p.k**, zotëron **1 (një)** kuotë me vlerë të përgjithshme prej **100,000 (nje qind mijë) lekë** që përbën **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë;

### **NENI 6. Pronësia mbi kuotat.**

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen, nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shit-blerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- në çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj.

### **NENI 7. Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme, vendos për zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

### **NENI 8. Eksperti (ët) Kontabël të Autorizuar**

Nëse kërkohet nga ligji apo nëse është marrë një vendim nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe i librave kontabël të Shoqërisë do të kryhet nga Eksperti Kontabël i Autorizuar i cili emërohet në bazë të ligjit dhe këtij statuti.

### **NENI 9. Përdorimi i të ardhurave neto.**

E ardhura neto që rezulton mbasi zbriten shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuotat që rritin kredinë për investime, pagat e shpërblimet, përdoret nga Ortakët, sipas qëllimeve të tyre.



### **NENI 10. Bilanci, plani financiar.**

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhë të vendit ose në monedhë të huaj sipas vlerësimit të Ortakëve ose ekspertëve sipas miratimit të Ortakëve të Shoqërisë.

Viti ushtrimor mbyllet në 31 dhjetor të cdo viti.

Në fund të cdo viti ushtrimor, organi administrativ procedon me hartimin e bilancit të vitit ushtrimor, brenda afateve dhe në përputhje me dispozitat e ligjit.

Bilanci mund t'u paraqitet ortakëve për miratim brenda 180 (njëqind e tetëdhjet) ditëve nga mbyllja e vitit ushtrimor. Dokumentat e kontabilitetit, të shoqëruar, nëse është e nevojshme, nga relacioni i ekspertëve kontabël të autorizuar, duhet t'i komunikohen ortakëve dhe të vihen në dispozicion të tyre në selinë e Shoqërisë, të paktën 15 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë.

### **NENI 11. Shpërndarja e fitimeve dhe kufizimi i shpërndarjeve të fitimeve**

Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

- a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
- b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

Administratori lëshon një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e mësipërme.

Kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojë këtë certifikatë.

Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese.

Administratori, i cili nga pakujdesia lëshon një certifikatë të pasaktë të aftësisë paguese, përgjigjen personalisht përpara shoqërisë për kthimin e dividendëve të shpërndarë.

Ortakët, që kanë marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjen personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendëve, që u janë shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur, pavarësisht lëshimit të certifikatës, këta ortakë kanë pasur dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, ose në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishin pasur dijeni për këtë gjendje.

## **III. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE.**

### **NENI 12.**

Ortakët mbajnë përgjegjësi për humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara.

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të saj. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të lihen peng e hipotekë me miratimin e Ortakëve Themelues.

### **NENI 13. Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve.**

Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kapitalit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Heqja dorë nga shoqëria nuk i liron ata nga detyrimet që ata kanë ndaj shoqërisë deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk rrezikon marrjen e të ardhurave nga shoqëria të siguruar deri në atë moment. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. Ata gëzojnë, të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj të përcaktuar në nenin 1.

#### **NENI 14. Abuzimi i ortakëve ndaj shoqërisë**

Ortakët, e shoqërisë tregtare, që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht e në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasurinë e tyre nëse:

- a) abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme;
- b) trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre;
- c) në çastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme, për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitale të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

#### **NENI 15. Largimi/përjashtimi i ortakut nga shoqëria dhe likuidimi i kuotës**

Largimi dhe përjashtimi i ortakut do të kryhet në përputhje me nenet 101, 102 dhe 103 të “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ndryshuar.

### **IV. ORGANET E SHOQËRISË.**

#### **NENI 16. Asambleja e Përgjithshme**

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme merr vendime të cilat kërkojnë  $\frac{3}{4}$  e votave (që përfaqësojnë të paktën 75% të kapitalit themeltar) në rastet e mëposhtme:

1. ndryshimet e statutit;
2. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
3. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
4. shpërndarjen e fitimeve;
5. raste të tjera të parashikuara nga ligji ose statut;

Për rastet e tjera ajo vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës si më poshtë:

1. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
2. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
3. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
4. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
5. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
6. përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
7. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

#### **NENI 17. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme**



17.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e thirrur rregullisht përfaqëson të gjithë ortakët dhe vendimet e saj, të marra konform ligjit dhe këtij statuti, përbëjnë detyrim ligjor për të gjithë ortakët, edhe nëse mungojnë ose nuk janë të të njëjtit mendim.

17.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nga Administratori dhe ose Administratorët nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

17.3 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nga administratorët, edhe jashtë selisë së Shoqërisë, por brenda territorit të Shqipërisë sipas procedurës së mësipërme të përcaktuar në pikën 18.2.

17.4 Kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

17.5 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është e detyruar dhe me çdo kusht të mbledhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë në rastet e mëposhtme:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- Shoqëria, propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aktiveve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara;
- Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aktiveve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

17.6 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nga ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblesë e Përgjithshme të Shoqërisë. Në këtë rast ortakët i kërkohen Administratorit me shkrim apo me postë elektronike thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Kërkesa duhet të mbajë arsyet, objektivat dhe çështjet për të cilat Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë.

17.7 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve drejtohet nga Kryetari i Asamblesë. Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve do të zgjidhet nga ortakët e pranishëm në Asamblesë e Përgjithshme të Ortakëve.

17.8 Ortakët mund të përfaqësohen në Asamble nga persona të tjerë, edhe jo ortak, nëpërmjet një prokure të posaçme të lëshuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

17.8.1 Prokura është e vlefshme vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për të cilën lëshohet dhe është e vlefshme edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

## **NENI 18. Kuorumi i nevojshëm dhe vendim-marrja**

18.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% për qind të kuotave.

18.2 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

  
Faqja 6 nga 9

18.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, është mbledhur në mënyrë korekte, por numri i kërkuar i ortakëve për të plotësuar kuorumin nuk është prezent apo nuk është i përfaqësuar, Asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

18.4 Kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk është thirrur sipas formaliteteve të ligjit ose këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

18.5 Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave.

#### **NENI 19. Procesverbali i mbledhjes se asamblesë**

19.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

19.2 Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga Kryetari i Asamblesë dhe nga mbajtësi i procesverbalit.


19.3 Në rast se shoqëria ka faqe interneti, Administratori duhet të publikojë një kopje të procesverbalit në faqen e internetit të shoqërisë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e Mbledhjes.

#### **V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

##### **NENI 20.**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

Administratori i parë i Shoqërisë është **Gazmend Elbasani**, atësia Qazim, amësia Merita, shtetas Shqiptar, lindur në Krujë dhe banues në KRUIË, me adresë Dajve 00840013; Nd. 22; H. 1; Krujë; Krujë; 1501; Krujë, lindur më 06/04/1991, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Leternjoftim ID nr. 036721319 dhe nr. personal J10406014W, me një afat emërimi prej **5 (pesë) vitesh**, afat ky fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

  
(Nënshkrimi)

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

##### **NENI 21. Të drejtat dhe detyrimet e administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

1. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

2. përfaqësojë shoqërinë tregtare;
3. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesë këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
5. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
7. raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
9. Të njoftojë Asamblesën e përgjithshme në lidhje me implementimin e politikave tregtare dhe për realizimin e transaksioneve që kanë rëndësi të veçantë për ecurinë e shoqërisë.
10. të thërrasë asamblesën e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% për qind të aktiveve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara dhe kur sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
11. Në rast se Asambleja e Përgjithshme cakton më shumë se një Administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.
12. Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **NENI 22. Shpërblimi i administratorëve**

Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorëve përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme.

Shpërblimi, duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë.

Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, asambleja e përgjithshme mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.

Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorëve në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

### **VI. MARRDHËNIET E PUNËS.**

#### **NENI 23.**

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrëdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

#### **NENI 24.**

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që i shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht.

### **VI. PRISHJA E SHOQËRISË. LIKUJDIMI.**

#### **NENI 25. Prishja e shoqërisë**



25.1 Prishja e Shoqërisë vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me vendimin e favorshëm të ortakëve që përfaqësojnë  $\frac{3}{4}$  e kapitalit të Shoqërisë, për shkaqet e parashikuara nga ligji ose në rastet e përcaktuara nga të gjithë ortakët me marrëveshje.

25.2 Në rast prishje, Shoqëria vihet në likuidim.

25.3 Për të administruar këtë procedurë Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve emëron një apo më shumë likuidues, të cilët paraqesin relaiconin final mbi gjëndjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë mbi operacionet e likuidimit dhe në afatet kohore të nevojshëm për të mbyllur likuidimin.

25.4 Në përfundim të procedurës së likuidimit Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve do të vendosë mbi bilancin financiar definitiv, mbi vlefshmërinë e punës së kryer prej likuiduesit dhe mbi përfundimin e likuidimit.

25.5 Pas pagesës së kreditorëve dhe bledhjes së kredive, likuiduesi/it do t'ia shpërndajë të ardhurat e mbetura nga likuidimi i ortakëve, proporcionalisht me kuotat e Shoqërisë që secili prej tyre ka respektivisht në pronësi.

25.6 Shoqëria në cdo moment mund ta revokojë gjëndjen në likuidim, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të marrë me shumicën e kërkuar nga ky statut.

25.7 Dispozitat lidhur me vendimet e ortakëve, asambletë si dhe organet administrative, aplikohen nëse është e mundur ligjërisht edhe përgjatë likuidimit.

## VII. DISPOZITA TË FUNDIT.

### NENI 26

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### NENI 27.

Gjithçka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut, do të disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### NENI 29.

Ky Statut është hartuar në Tiranë (Shqipëri) në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërjetje nga Ortaku.

**ORTAKU THEMELUES**  
Shoqëria "EBG sh.p.k,

Përfaqësuar nga Ortaku  
z. Erion Gina

Administratori  
Ermal Buka

